

## **Të rinjtë duan qasje në vendimmarrje e punë praktike në institucionet komunale**

Komuna e Pejës, sikurse të gjitha komunat tjera të Kosovës, pjesën më të madhe të popullatës e ka të re dhe nëse analizohet përherë do të shihet se si roli i rinisë në ndryshimin pozitiv në fusha të përgjithshme, jo vetëm që ka qenë i madh, por shpeshherë ka qenë edhe më i fuqishmi dhe iniciues i shumë politikave e fushave ku interes ka qenë mirëqenia e qytetarëve në përgjithësi dhe e të rinjve në veçanti.

Andaj, edhe pushteti lokal apo institucionet në nivel lokal, duke pasur këtë potencial të rinjve parasysh duhet të përpiqen t'i japin prioritet të rinjve dhe përfshirjes së tyre në vendimmarrje, si në hartimin e politikave po ashtu edhe në zbatimin e tyre.

Mirëpo, duket se as komuna e Pejës nuk është ndër ato komuna që pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje e ka të rregulluar në mënyrë të duhur. Fakti që pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje është e vogël dhe e pamjaftueshme është potencuar edhe nga vetë të rinjtë e kësaj komune të cilët vijnë nga fusha të ndryshme, si studentë të Universitet Publik "Haxhi Zeka", ata të shoqërisë civile, të rinj vullnetarë, e të tjerë.

Përveç se nuk janë të kënaqur më përfshirjen e tyre dhe zërit të tyre në vendimmarrje, këta të rinj kanë kërkuar që institucionet komunale të ofrojnë edhe mundësi të kryerjes së punës praktike për ta në institucione publike e komunale. Ata besojnë se potenciali dhe vullneti që kanë përpos që do t'u krijonte lehtësi atyre ta kryejnë punën praktike profesionale në institucione, por edhe institucionet do të përfitonin nga puna e tyre në fusha të ndryshme të cilat Komuna do të mund t'ua përcaktonte.

Në anën tjetër, zyrtarët komunalë të pranishëm në takimin e përbashkët me të rinjtë thanë se pavarësisht vlerësimeve të të rinjve se nuk qëndrojnë mirë me pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje, ata theksuan se Komuna e Pejës është njëra ndër komunat që ka marrë edhe çmime për vlerësim si komuna më transparente në Kosovë. Ndërsa, sa i përket punës praktike për të rinj ata thanë se më herët është praktikuar një gjë e tillë, por kjo nuk është bërë në mënyrë sistematike pasi që paraqet një problem teknik e financiar, duke marrë për shembull punën e

madhe që ka administrata komunale dhe buxhetin e vogël për të mbuluar shpenzimet nëse do angazhonin të rinj për punë praktike.

Megjithatë, duke parë vullnetin, energjinë dhe kapacitetet që shprehen këta të rinj zyrtarët komunalë u zotuan se do të angazhohen dhe avokojnë tek qeveria e donatorët e mundshëm për të ndarë mjete për t'u mundësuar këtyre të rinjve punën praktike në institucione si dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje. Ky zotim erdhi pas vlerësimit të të rinjve se Komuna e Pejës nuk është që ka shumë takime e kontakte më ta dhe kërkuan nga institucionet që ky komunikim dhe takimet të jenë shumë më të shpeshta. Për më tepër, zyrtarët komunal premtuan dhe u zotuan se do të bëjnë krejt çka është e mundur që të rinjve t'u sigurohet pjesëmarrje më aktive në debate publike me Komunën përmes bashkëpunimit me bashkësitë territoriale dhe organizatat tjera të cilat janë aktive në këtë komunë.

Duke parë gjithë dialogun që u zhvillua në mes të rinjve dhe zyrtarëve komunal dhe faktin që të rinjtë përbëjnë 50% të popullatës jo vetëm në Pejë por në nivel shteti, u vlerësua se ata duhet të jenë pjesëmarrës në organizma të rëndësishëm të vendimmarrjes, sepse të rinjve duhet t'u besohet në vlerat përfaqësuese, në fuqinë e tyre dhe ndikimin në shoqëri të cilët mund të shtyjnë vendimmarrësit të fuqizojnë profesionalizmin e institucioneve, rritjen e llogaridhënies dhe transparencës, përmirësimin e mirëqenies dhe pozitës së tyre në shoqëri.

Ky dialog i të rinjve me Drejtorin e Administratës Komunale dhe Shefin e Zyrës Ligjore në Pejë u organizua nga OJQ Syri i Vizionit në kuadër të programit "Rritja e qasjes në drejtësi në nivel komunal" mbështetur nga organizata Nisma për të drejtat e njeriut - Kosovë (YIHR KS) dhe financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit (INL).

"Ky editorial është mundësuar me mbështetjen e YIHR KS dhe financuar nga Departamenti i Shtetit Amerikan (INL). Përmbajtja e këtij editoriali është përgjegjësi e plotë e OJQ Syri i Vizionit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e INL apo YIHR KS"